

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

NATURAL HERBAL E.V.R SH.P.K

*Ne Pogradec sot me daten 20 shkurt 2024 bazuar ne ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregtare", ne ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te regjistrimit", une ortaku i vetem themelues Z. Rolandi Gypi i biri i Selamiut ,i datlindjes 18/09/1967,lindur ne Maliq,banues ne Blloku nr 3 Sheshi Puntori, Maliq, vendosa te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **NATURAL HERBAL E.V.R SH.P.K.** e cila do te zhvilloje aktivitetet tregetar ne Republiken e Shqiperise*

Neni 1

*Ne kuptimin e ketij Akti Themelimi ortaku i vetem themelues Z. Rolandi Gypi i biri i Selamiut ,i datlindjes 18/09/1967,lindur ne Maliq,banues ne Blloku nr 3 Sheshi Putori, Maliq eshte themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **NATURAL HERBAL E.V.R SHPK** me seli ne adresen Nr pasurie 780/77,Zona kadastrale 3803 ,ndertese Korçe-Vlocisht,rruga Drithas-Pojan km1.*

Neni 2

Veprimtaria e Shoqerise, marredheniet e saj me persona te trete, private e shteterore, rregullohet ne baze te Legjislacionit Shqiptar,te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregtare" , , dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ligjeve te mesiperme si dhe te Statutit e kesaj Shoqerie dhe Aktit te Themelimit te saj.

Neni 3

Per detyrimet e veta shoqeria pergjigjet me pasurite e saja.

Neni 4

Objekti I veprimtarise, emertimi, selia e shoqerise, shtimi i ortakeve dhe ato çka jane percaktuar ne Statut mund te ndryshojne me vendimin e ortakut dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 5

Objekti I veprimtarise se Shoqerise **NATURAL HERBAL E.V.R** SH.P.K do te jete: Grumbullim,perpunim,perzgjedhje,paketim,etiketim,magazinim dhe tregetim me shumice dhe pakice te bimeve medicinale dhe aromatike,erezave dhe vajrave esenciale,export-import

Neni 6

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijojte filiale, dege e perfaqësi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin e vendeve ku do te ushtroje aktivitetin.

Neni 7

Akti i Themelimit do te jete efektiv nga dita e regjistrimit te Shoqerise ne "Qendren Kombetare te regjistrimit QKR". Nga kjo dite shoqeria fiton statutin e Personit Juridik te pavarur. Por aktivitetin e saj mund ta ushtroje pasi te jete regjistruar ne zyrat e tatim-taksave.

Neni 8

*Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete e pa kufizuar.Aktiviteti i saj konsiderohet i filluar ne momentin e nxjerrjes se numrit te NIPT-it ne "Qendren Kombetare te regjistrimit QKR" duke kryer te gjitha procedurat e deklarimit dhe te regjistrimit prane organeve shteterore ne rrethin perkates ku shoqeria **NATURAL HERBAL E.V.R** SH.P.K ka seline e saj.*

Neni 9

*Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100 (Njeqinte) leke, Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100 (njeqint) leke, Ai eshte i ndare ne 1 (nje) kuota ku vlera nominale e 1 kuote eshte 100 (njeqint) lek Ai eshte kontribut i ortakut te vetem Z. Rolandi Gypi ,ne masen 100 pjese, dhe eshte derdhur teresisht para firmosjes se statutit te shoqerise tregtare **NATURAL HERBAL E.V.R** SH.P.K.*

Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te "Asamblese se ortakeve". Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket qe te kete te drejta pronesie dhe aktivite jashte kesaj shoqerie. Kapitali i shoqerise mund te rritet sipas deshires se ortakeve dhe kushteve ne te cilat do ta ushtroje veprimtarine shoqeria.

Neni 10

Aktet dhe çdo dokument i Shoqerise hartohet nga ortaku ose "Asambleja e ortakeve" dhe firmoset prej tij, ose prej perfaqesueseve te asamblese se ortakeve. Ne raste te tjera perfaqsimi dhe çdo dokument i Shoqerise hartohet vetem nga administratori dhe firmoset prej tij. Emertimi i shoqerise do te shenohet ne te gjitha dokumentat duke u ndjekur menjehere nga inicialet Sh.p.k. Shoqeria do kete vulen dhe logon e saj.

Neni 11

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte t'i perdore ato ne perputhje me objektin e qellimin e veprimtarise se saj dhe legjislacionin ne fuqi. Pas miratimit te bilancit vjetor dhe raportit financiar vjetor nga ortaku, fitimi neto i perket ortakut ne masen e plote dhe mund te perdoret lirisht prej tij brenda e jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 12

Shoqeria mund te krijojte disa fonde: Fondin Themeltar, Fondin Rezerve e Fondin e Shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te percaktoje edhe fonde te tjera.

Neni 13

Shoqeria do te çeli llogari ne Banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, EURO, USD e ne monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ortaket ose persona te autorizuar prej tij.

Neni 14

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te miratohet nga Asambleja e Ortakeve brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 15

Per nevoja te veprimtarise se saj Shoqeria mund te beje punesime te punonjesve duke lidhur kontrata sipas ligjit ne fuqi.

Neni 16

*Administratori i shoqerise **NATURAL HERBAL E.V.R SH.P.K.** do te jete Z. Emiljan Gypi ,me nje afat kohor prej 5 (pese) vjet,detyrat dhe kompetencat e te cilit percaktohen ne statut.*

Neni 17

Ortaket dhe personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit e burimit te tij, njohurite e pervojen e fituar apo shkembyer ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise, si dhe fshehtesine e gjendjes financiare te saj. Ata jane te detyruar te ruajne te fshehte identitetin e shumave te te ardhurave te shoqerise, depozitave te saja dhe veprimtarine e shoqerise te pasqyruar ne bilancin vjetor. Ndaj atyre qe shkelin keto rregulla Ortaku "administratori" ka te drejte te marre masa ndeshkimore.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

ROLANDI GYPI

Rolandi GYPI
R